



## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **POLICIA E KOSOVËS, Rr. "Luan Haradinaj" nr. 99, 10000 Prishtinë**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **214-19-1286-1-1-1, Nr i brendshem: 214/19/008/111**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me vajra për automjetete"**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**"BALLKAN PETROL" SHPK**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**ZONA INDUSTRIALE GËRLICË**

(Adresa)

**FERIZAJ**

(Vendi)

**70000**

(Kodi postar)

**049/113 543**

(Numri Telefonit)

**N/A**

(Numri i Faks-it)

**BEKIM ALITI**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**info@ballkanpetrol.com**

**15.05.2019**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me **PROKURË**.

Shëno të dhënat si në vijim:

**Nuk angazhoj avokat**

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë në platformën elektronike E-prokurimi është publikuar me datën 01.04.2019, tenderi: “**Furnizim me vajra për automjetete**” me nr prokurimi **214-19-1286-1-1-1**, Nr i brendshëm: **214/19/008/111..**  
Afati i fundit për sqarimin e dosjes së tenderit - 19.04.2019  
Data e parashtrimit të pyetjeve sqaruese nga “Ballkan Petrol” SHPK - 19.04.2019  
Pergjigja në pyetjet sqaruese nga AK - 24.04.2019

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

Po ☐

Jo ☒

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kërkesë për rishqyrtim në AK - 25.04.2019  
Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 26.04.2019  
Kërkesë e perseritur për rishqyrtim në AK - 30.04.2019  
Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 30.04.2019  
Vendimi i kërkesës për rishqyrtim –Auto Zone-30.04.2019  
Kërkesë e ri përsëritur për rishqyrtim në AK – 03.05.2019  
Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 06.05.2019  
Kërkesë e ri përsëritur për rishqyrtim në AK – 09.05.2019  
Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 13.05.2019

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues



*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 1 Qëllimi**

**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi**

**Neni 28 Specifikimet Teknike**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

- Duke u bazuar në specifikacionet e dhëna në dosje të tenderit ku qartë shifet se janë përpiluar ose nga mosnjohja e kësaj lëmie ose favorizimi për ndonjë subjekt të caktuar, ne si OE disa here kemi kërkuar nga AK që ti rishqytoj dhe ti përmirësoj specifikacionet teknike të dosjes së tenderit konform rregullave të aplikueshme.
- Të gjitha pyetjet i kemi paraqitur në kërkesën për sqarime më 19.04.2019. (dokumenti i bashkangjitur)
- Më 24.04.2019, AK na ka kthyer përgjigjet në pyetjet për sqarim, por përgjigjet kanë qenë gjysmake dhe jo të plota. (dokumenti i bashkangjitur)
- Më 25.04.2019 kemi deponuar pranë AK kërkesën për rishqyrtim (dokumenti i bashkangjitur) dhe ditën e nesërme kemi pranuar refuzimin e kërkesës si të pabazuar (dokumenti i bashkangjitur) ku sipas mendimit tonë kërkesa jonë nuk është trajtuar fare në aspektin teknik por vetëm është arsyetuar me: **"AK sqaron se duhet të respektohen kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues"**
- Ne edhe njëherë më 27.04.2019 kemi ripërsëritur kërkesën tonë për rishqyrtim, por kësaj radhe kërkesa jonë nuk është shqyrtuar fare dhe kanë kërkuar që ti drejtohem OSHP-së.
- Ndërkohë OE "Auto Zone" shpk në bazë të përgjigjeve që na u janë dhënë neve më 30.04.2019 për artikullin 8, vaj për motoçikleta SAE 20W-50 ka kërkuar që të përmirësohet sqarimi dhe që në vend të vajit full sintetik të pranohet edhe vaj multigradë, e që AK e ka pranuar një sugjerim të tillë.
- Ne menjëherë reaguam se si është e mundur që AK të përdor kriteret të dyfishta për një artikull. Neve na thotë se vaji duhet të jetë full sintetik, ndërsa për tjetrin operator pranon që të ofrohet edhe vaj gjysëm sintetik dhe multigradë.
- Sa për sqarim, dallimi si në kualitet ashtu edhe në çmim mes vajit full sintetik dhe vajit multigradë është jashtëzakonisht shumë i madh dhe në bazë të rëndësisë së përdorimit në motoçikletat e Policisë së Kosovës vaji multigradë është i dëmshëm për përdorim.
- Dëshmitë e ofruara prap nuk kanë qenë bindëse për AK dhe kërkesën tonë e ka refuzuar.
- Në mënyrë që lënda të zgjidhet brenda AK dhe mos të vie të OSHP-ja, prap më 09.05.2019 kemi bërë edhe një kërkesë për rishqyrtim, por edhe kësaj here si herave tjera nuk kemi marrë përgjigje adekuate. Andaj meqë nuk patëm rrugdalje tjetër ishim të obliguar që të ju drejtohem OSHP-së.
- Krejt çka i kemi kërkuar Autoritetit Kontraktues ka qenë që specifikacionet më të larta të mbizotërojnë në vlerësimin e tenderit dhe specifikacionet më të ulta mos të jenë obliguese dhe kriter eliminimi dhe domosdoshmërisht mos të jenë të përfshira në çertifikatë dhe etiketë (ambalazh) të produkteve.
- Disa herë i kemi kërkuar AK se a mjafton që vetëm specifikacioni më i lartë të mbizotëroj në çertifikatë dhe në etiketë për shembull:
  - E7 ta mbuloj edhe E1,
  - A3/B4 ta mbuloj edhe A3/B3,
  - PSA B71 2300 të mbuloj edhe PSA B71 2294
  - MB 236.7, MB 236.9 të mbuloj edhe MB 236.6



- MB 236.3, MB 236.5, MB 236.7 të mbuloj edhe MB 236.1  
Por për çudi AK ka thënë se **NUK LEJOHEN!**

- Specifikacionet që i ka kërkuar AK në dosje të tenderit në përgjithësi janë të paarritshme për prodhuesit e vajrave me renome botërore siq janë **Shell, Mobil, Chevron Texaco, Castrol, British Petrol**, etj. dhe si të tillë e kanë të pamundur të ofertojnë të vetëm në këtë tender.

- Për këtë e kemi dëshmuar edhe me certifikatat e disa prodhuesve të njohur, por prap kjo nuk ka qenë bindëse për AK.

- Ju lutem analizonë fjalinë e mëposhtme se çka kërkon AK:  
*Çdo specifikë e kërkuar në dosje të tenderit duhet të ketë përmbajtjen me pike e presje në certifikatë dhe etiketë (ambalazh), me përjashtim të produktit me nr rendor 2 të Pjesës 1 ku i lejohet ti ketë vetëm në etiketë (ambalazh)".*

Pra kërkohet që çdo specifikë e kërkuar **me pikë e presje!!!** të prezantohet në certifikatë dhe etiketë të produktit. Kjo nuk do koment dhe është për keqardhje se çfarë joprofesionalizmi po tregon AK.

- Duhet ti bëhet e qartë AK se prodhuesit me renome kanë avancuar prodhimet e tyre dhe kjo nuk ka kurrfarë logjike që për të ju përshtatur rasteve dhe kërkesave individuale të kthejnë prodhimet e vjetra në funksion.

- Vlen gjithashtu të theksohet se ky aktivitet prokurimi që nga data 05.04.2018 është në tenderim dhe dy herë është anuluar dhe zvarritet pikërisht për specifikacionet e dhëna jo të aplikueshme. Nëse shikohet historiku i këtij aktiviteti të prokurimit, ne si OE jemi eliminuar dy herë edhe pse oferta jonë ka qenë e kompletuar dhe se janë gjetur disa detaje minore të cilat do të duhej të sqaroheshin duke pasqyruar përbazë se oferta jonë ka qenë dukshëm më e lirë se e OE tjerë (bashkangjitur kopja për tenderuesin e eliminuar).

**Konkluzion:**

- **Kërkojmë nga Organi i Shqyrtues i Prokurimit që ti merr përbazë dëshmitë dhe vërejtjet e dhëna dhe ta obligoj AK që ti rishikoj dhe përmirësoj specifikacionet teknike të tenderit, në mënyrë që të jenë konform me aplikimet aktuale në industrinë e vajrave.**

## 9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 13.05.2019
2. Kërkesa e perseritur për rishqyrtim të AK - 09.05.2019
3. Dokumenti nga ACEA
4. Certifikatat e disa nga prodhuesve të vajit 10W-40
5. Specifikimet teknike të përmirësuar
6. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim-06.05.2019
7. Kërkesa e perseritur për rishqyrtim të AK - 03.05.2019
8. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim-Auto Zone-02.05.2019
9. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 30.04.2019
10. Kërkesa e perseritur për rishqyrtim të AK - 30.04.2019
11. Vendimi i kërkesës për rishqyrtim - 26.04.2019
12. Kërkesa për rishqyrtim të AK - 25.04.2019
13. Pyetje e pergjigje - 24.04.2019

14. Eliminim Ballkan Petrol - 04.06.2018
15. Njoftim për Kontratë
16. E-Prokurimi kërkesa per sqarime
17. E-Prokurimi kërkesa per rishqyrtime
18. Urdherpagesa dhe Fletepagesa per ankese

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*